



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 260/prot.

Pogradec , më 24.08.2026

Njoftim për konsultim publik

PËR FILLIMIN E PROCEDURËS SË KONSULTIMIT PUBLIK, PËR PROJEKT VENDIMIN:

“Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”

Propozuesi : KUVENDI

1.Sqarime për projekt-aktet :Nga KUVENDI është propozuar Projekt-Ligji me titull:

“Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”

Me qëllim

- Organizimi i brendshëm të kalohet nga skema Bashki- Njësi Administrative në skemën Bashki-Qytet-Njësi-Administrative.
- Ruajtjen e identitetit historik dhe qytetar të qyteteve, të forcojë përfaqësimin e tyre politik, të afrojë koordinimin e shërbimeve me komunitetin dhe të krijojë një nivel më të qartë territorial për planifikimin e zhvillimit dhe monitorimin e performancës.

2.Kalendari i konsultimit : *Aktivitetet organizohen sipas kalendarit të konsultimit publik bashkangjitur këtij njoftimi*

Pjesëmarrës nga ana e Këshillit të Bashkisë :

Format e konsultimit :

- Konsultim me takime fizike.
- Vjelje mendimi nëpërmjet postës dhe postës elektronike.

Qëllimi i këshillimit publik

Duke qënë se është dërguar Projekt-Ligji nga Kuvendi për shqyrtim propozimi n mbledhje dhe miratimi i mendimit duke pasqyruar qëndrimet , Këshilli po organizon konsultimin dhe informimin e banorëve ne lidhje me :

	“Ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” <i>Këshilli Bashkiak është i interesuar të marrë mendimet e banorëve të Bashkisë Pogradec dhe Njësive Administrative a janë dakort me propozimin nga Kuvendi</i> <i>Kështu, Këshilli i Bashkisë kërkon mendime dhe sygjerrime si më poshtë:</i> <i>1. A është komuniteti dakort ?</i> <i>2. Për të sqaruar këtë pyetje Këshilli fton të gjithë komunitetin të jap mendime dhe sygjerrime me qëllim që çdo vendimarrje të jetë e dakortësuar dhe e favorshme për të gjitha grupet e interesit.</i> <i>Këshilli i Bashkisë është i interesuar të marrë mendimet e banorëve të Bashkisë Pogradec, Këshilli i Bashkisë kërkon mendime dhe sygjerrime si më poshtë:</i> <i>3. A janë dakort banorët që të bëhen këto ndryshime ?</i> <i>Për të sqaruar këtë pyetje Këshilli fton të gjithë komunitetin të japin mendime dhe sygjerrime me qëllim që çdo vendimarrje të jetë e dakortësuar dhe e favorshme për të gjitha grupet e interesit.</i>
Përshkrimi i çështjes që trajton projekt-akti	Modeli I propozuar ruan Bashkinë si të vetmen njësi të vetëqeverisjes vendore, me një kryetar , një këshill, një administratë dhe një buxhet të vetëm. Organizimi I brendshëm propozohet të kalojë nga skema Bashki- Njësi Administrative në skemën Bashki- Qytet- Njësi Administrative. Qyteti do të shërbejë si njësi funksionale e planifikimit, përfaqësimit dhe organizimit të shërbimeve. Për çdo qytet propozohet caktimi I një nënkryetari përgjegjës për koordinimin administrative dhe zbatimin e shërbimeve në territorin përkatës.
Pyetjet që ngre Këshilli ndaj publikut	<i>Me qëllim për të orientuar (por jo kufizuar) mendimet dhe sygjerrimet tuaja këshilli ngre për ju disa pyetje për të dhënë mendime në mënyrë që të jetë sa më qartë sygjerrimi juaj dhe rrjedhimisht vendimarrja e Këshillit.</i> <i>- A jeni dakort për ndryshimet që propozohen të bëhen ?</i> <i>Çdo sygjerrim tjetër është i mirëpritur.</i>
Detaje të çdo takimi publik apo dëgjese publike që do të organizohet në lidhje me projekt-aktet për këshillim;	<i>- Takimet fizike do të realizohen sipas kalendarit bashkangjitur për grupe të interesit duke përshtatur oraret për të siguruar pjesëmarrjen e grupeve të interesit pa penguar zhvillimin e aktivitetit të tyre normal.</i> <i>- Sygjerrimet mund të dërgohen edhe me postë në adresën: Bashkia Pogradec, Bulevardi Rreshit Çollaku, Lagj. 2, Pogradec ose në adresën elektronike keshillibashkiakpogradec@gmail.com</i>

Kontaktet dhe afatet e dërgimit të komenteve, rekomandimeve, vërejtjeve;	Në pamundësi për të marrë pjesë në takimet fizike cdo banor, ose grup intermund të dërgojë sygjërimet e tij në postë në adresën: Bashkia Pogradec, Buleva Rreshit Çollaku, lagj. 2, Pogradec ose në adresën elektron keshilibashkiakpogradec@gmail.com , deri në datë 21.09.2026
Projekt-vendimi, relacioni shoqërues, studime apo materiale me informacion në lidhje me çështjen që konsultohet	Bashkangjitur gjeni: - Projekt-Ligjin e paraqitur . - Relacionet shoqëruse.
Shpjegim të procesit që do ndjekë dhe veprimet që do të ndërmarrë Këshilli për të shqyrtuar rekomandimet nga publiku deri në marrjen e vendimit	Këshilli i Bashkisë do të trajtojë me kujdes dhe seriozitet cdo sygjërim tuaj. Procesi i marrjes së mendimeve dhe sygjërimeve do të koordinohet me sekretariati i keshillit dhe konkretisht: - Për cdo takim fizik do të mbahen proces verbalet me të gjitha sygjërimet dhe proces verbali do behet publik. - Do hartohet raporti përmbledhës me gjithë rekomandimet e marra në takimet, pyetësori dhe anketimi si dhe ato të mbëritura me postë. Raporti publikohet. - Rekomandimet do t'ë dërgohen Kryetarit të Bashkisë për të dhënë mendime të tij. - Përmbledhja e rekomandimeve dhe mendimet e Kryetarit të Bashkisë paraqiten komisionit të Keshillit për ekonominë. (do publikohet). - Komisioni do shqyrtojë cdo sygjërim dhe mendim të kryetarit dhe do propozojë Keshillit cdo rekomandim (do publikohet). - Vendimarrja e Keshillit për këtë çështje do zhvillohet publikë, on-line dhe vendimarrja do publikohet.
Data e publikimit	Datë 24. 08 .2026

SEKRETARE E KËSHILLIT

Jona BOJKO

